



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 1524 / prot.  
6

Tiranë më 4.11.2021

REKOMANDIM

Nr. 57, datë 4.11.2021

PËR KONTROLLUESIN “SPITALI BASHKIAK LUSHNJË”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Spitali Bashkiak Lushnjë” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 135, datë 15.09.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), si dhe në mbështetje të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, datë 03.06.2021 “Për miratimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2020”, u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi.

Zyra e Komisionerit, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Spitali Bashkiak Lushnjë ofron kujdesin mjekësor me anë të poliklinikës së specialiteteve, shërbimin e Pranim – Urgjencës, laboratorit klinik – biokimi dhe

bakteriologjik dhe shërbimin me shtretër në specialitetet e veta. Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale dhe sensitive për subjektet e të dhënave personale “punëmarrës”, “ish-punëmarrës”, “pacientë” dhe “vizitorë”. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Nga verifikimi kryer rezulton se, dosjet personale të subjekteve të të dhënave “ish-punëmarrës” (personelit mjekësor dhe jo-mjekësor) përmbajnë të dhëna (dokumente origjinale, të noterizuara dhe/ose të fotokopjuara) të formimit arsimor, profesional, certifikata familjare/personale ose kopje të kartës së identitetit, vërtetim të gjendjes gjyqësore, etj. Kontrolluesi nuk ka parashikuar asnjë afat kohor për ruajtjen e tyre, në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale, parashikuar në germen “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi ka detyrimin të përpunojë të dhënat personale për aq kohë sa ka të nevojshme për të arritur qëllimin duke mos tejkaluar atë dhe në momentin që qëllimi ka përfunduar, lind detyrimi të realizojë shkatërrimin/fshirjen e tyre, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i të dhënave konsiderohet i paligjshëm.

3. Kontrolluesi disponon një sistem video-surveimit CCTV për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të institucionit, për qëllim të sigurisë së personelit dhe aseteve të Poliklinikës qendrore. Konstatohet se në ambientet e brendshme si korridore, recepsion etj., janë vendosur tabela njoftuese mbi prezencën e sistemit të video surveimit CCTV, por tabela nuk përmban elementët informues sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit, datë 05.03.2010 “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video surveimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera” i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 3”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mos përmbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

4. Kontrolluesi ka lidhur kontrata me palë të treta: Kontratë Sipërmarrje me nr. 649/1 Prot., datë 07.07.2021 me shoqërinë “HELATH&LIGHT” SHPK, me objekt “Mirëmbajtje e Skanerit”.

Nga verifikimi i kontratës së lidhur me këtë shoqëri, rezulton se nuk janë reflektuar detyrimet sipas parashikimeve në nenin 20, të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi” i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 19”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose një shërbimi, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Detyrimet e përpunuesit për përpunimin e të dhënave personale, parashikohen në nenin 20 të Ligjit dhe rregullohen me aplikimin e Udhëzimit nr. 19.

5. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, rezulton se Kontrolluesi nuk ka “Njoftuar” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim mbi përpunimin e të dhënave personale, është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe në realizimin e detyrimeve ligjore të këtij të fundit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre sipas Ligjit.

6. Kontrolluesi nuk disponon rregullore “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Spitalit.

Kontrolluesi nuk ka marrë masa të përshtatshme sigurie, të cilat duhet të parashikojnë zhvillimet më të fundit teknologjike, natyrën sensitive të të dhënave që lidhen me shëndetin dhe vlerësimin e rrezikut të mundshëm, me qëllim parandalimin e rreziqeve të tilla si aksesit i paautorizuar tek të dhënat, shkatërrimi, humbja, përdorimi, pamundësia e aksesit të tyre, etj., në përputhje me parashikimet e nenit 27 të Ligjit, dhe pikës 4 të nenit 8 të Udhëzimit nr. 49, datë 02.03.2020 “Për mbrojtjen e të dhënave shëndetësore” (në vijim, “Udhëzimi nr. 49”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një “Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të neneve 27, 28 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 49, duke mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

7. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të pajisjes me Deklaratën e Konfidencialitetit të punonjësve, të cilët kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale dhe sensitive të subjekteve të të dhënave, në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit dhe Vendimin nr. 6 të Komisionerit, datë 05.08.2012 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale” (në vijim, “Vendimi nr. 6”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se qëllimi i nënshkrimit të *“Deklaratës së Konfidencialitetit”*, është që të gjithë punonjësit të cilët kanë akses në të dhënat personale, të kuptojnë qartë dhe drejtë detyrimet që ata kanë mbi përpunimin e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit. Në aktin formal me titull *“Deklaratë Konfidencialiteti”* dalë në zbatim të Vendimit nr. 6, punëmarrësit informohen mbi përgjegjësitë në rast përhapje në mënyrë abuzive të të dhënave personale tek personat e paautorizuar.

8. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Grupi i kontrollit konstaton mosplotësim të detyrimeve në lidhje ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit, datë 14.09.2018 *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 47”*), për shkak cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarisë që Kontrolluesi ushtron.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron (përpunon të dhëna sensitive), e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO/IEC 27001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit *“Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”*, si dhe është një sistem i certifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm me organizma të akredituar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ, hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit e vendosi në dispozicion të Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i Kontrolluesit ka dokumentuar rikuperimin e disa prej shkeljeve të konstatuara në përfundim të hetimit administrativ, si dhe ka deklaruar angazhimin, në vijim, për rikuperimin e shkeljeve të tjera, duke paraqitur:

- Sa i përket konstatimit për mbikëqyrjen nëpërmjet sistemit të video-survejjimit, Kontrolluesi ka paraqitur fotografi të tabelës informuese, sipas modelit standard të miratuar me Udhëzimin nr. 3;
- Kontrolluesi ka paraqitur nënshkrimin e Deklaratës së Konfidencialitetit me punëmarrësit të cilët kanë akses në procese përpunuese të të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe eviton mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 5, 18, 20, 21, 27, 28, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/l”), si dhe 32 të Ligjit,

### **REKOMANDOJ:**

1. Kontrolluesi të ketë në vëmendje të vazhdueshme përpunimin e të dhënave personale dhe sensitive në përputhje me dispozitat e parashikuara në nenin 5 të Ligjit dhe të Udhëzimit nr. 49, si dhe të marrë masa për adresimin e konstatimeve të Komisionerit sa i takon përcaktimit të afateve për ruajtjen e të dhënave personale;
2. Kontrolluesi të ketë në vëmendje të vazhdueshme informimin e subjekteve mbi përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video-survejjimit (CCTV), në zbatim të nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3;
3. Kontrolluesi, të përfshijë në marrëveshjen me përpunuesin përkatës, detyrimet sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19;
4. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të “*Njoftojë*” pranë Zyrës së Komisionerit, mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës;
5. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të marrë masa për hartimin e rregullores “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit;
6. Kontrolluesi në zbatim të nenit 28 të Ligjit, të ketë në vëmendje masat e nevojshme të sigurisë dhe konfidencialitetit me qëllim shmangien e aksesit dhe përhapjes së të dhënave nga persona ose subjekte të paautorizuar;
7. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me krijimin, mirëmbajtjen dhe

administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale;

8. Kontrolluesi, për shkak të natyrës së veçantë të aktivitetit që ushtron, duhet të marrë masat e nevojshme për të vlerësuar mbi certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48;
9. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
  - Brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 1, 3 dhe 5 më sipër;
  - Në mënyrë të vazhdueshme, detyrimet e treguara në pikat 2 dhe 6 më sipër;
  - brenda 10 (dhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 4 më sipër;
  - brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 7 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

10. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra.

Në rast mospërmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisionerit vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 4.11.2021.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

